

Maj 2024

Nr. (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
27	7.05.2024	Kërkese për informacion ne lidhje me: Ne baze te ligjit Nr. 30/2024 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar, neni 2 pika 61 “ “Hotel i shpërndarë” është një strukturë akomoduuese, i cili ofron shërbimet e mikpritjes për vizitorët, i përbërë nga shtëpi, apartamente ose dhoma të vendosura në ndërtesa të veçanta, ekzistuese, afër njëra-tjetrës, të menaxhuara nga i njëjti sipërmarrës turistik.” dhe pika 57 e	20.05.2024	Referuar ligjit Nr. 30/2024 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 93/2015, “PËR TURIZMIN”, I NDRYSHUAR, lidhur me informacionin e kërkuar nga ana juaj për kategorinë “Hotel i shpërndarë” i cili është një strukturë akomoduuese, që ofron shërbimet e mikpritjes për vizitorët, i përbërë nga shtëpi, apartamente ose dhoma të vendosura në ndërtesa të veçanta, ekzistuese, afër njëra-tjetrës, të menaxhuara nga i njëjti sipërmarrës turistik, ju bëjmë me dije se: Pas miratimit të ligjit të sipërcituar, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke punuar për hartimin e akteve nënligjore, dhe më pas do të realizohet përditësimi edhe në faqen zyrtare të ministrisë.	Përfunduar	0

		po këtij neni kërkoj te di: 1. Kriteret minimale që duhet të përmbushi stuktura akomoduese për secilën kategori 2. Mënyrën se si mund te aplikoj dhe kur fillojnë aplikimet pasi me ndryshimin e ligjit, faqja zyrtare e Ministrisë se turizmit dhe mjedisit nuk është përditësuar. 3. Për piken 61 te këtij neni ku citohet: “afër njëra tjetrës” cila është distanca e përafërt qe parashikohet nga ky nen. 4. Me ndryshimin e ligjit cila është periudha maksimale dhe minimale pas aplikimit kur mund te pajisem me certifikatën e kategorizimit si strukture akomoduese.				
--	--	--	--	--	--	--

28	10.05.2024	Kërkese për informacion ne lidhje me: Në datë 18.04.2023 nëpërmjet kërkesës për informacion dërguar institucionit tuaj kemi kërkuar të na vendosen në dispozicion kopjet e planeve të reja të menaxhimit për bashkitë Has, Malësi e Madhe, Korçë, Maliq, Berat dhe Gramsh, planet e reja të menaxhimit të bashkë financuara nga Banka Botërore, Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA) dhe Fondi për Mjedis Global (GEF). Ju nëpërmjet email-it të datës 24.04.2023 shpreheni se nuk e zotëroni informacionin e kërkuar dhe nëpërmjet nenit 10 të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”,	24.05.2024	Për pyetjen 1,2 dhe 3: Miratimi i planeve te mbarështimit ndjek procedurat e përcaktuara ne germën "b", te pikës 2, te nenit 11, te ligjit 57/2020, date 30.04.2020 "për pyjet". Informacioni qe përmbajnë këta plane mbarështimi, ka lidhje me planifikimin, përdorimin dhe administrimin e territorit te Njësisë se Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V) brenda te se cilës ato ndodhen. për pasoje dhënia e informacionit është një e drejte e padiskutueshme e NJ.Q.V. për pyetjet 4 dhe 5, ne lidhje me pagesat për shërbimet e renditura ne tabelën e përcjellë nga Znj****, apo nese këta fonde janë paguar për hartimin e planeve te mbarështimit, duhet t'i adresohen Ekipit te Menaxhimit te Projektit ne fjale. Sektori i pyjeve nuk ka ne disponon dhe as nuk disburson fonde ne lidhje me atë qe pretendohet ne këto pyetje. Ne lidhje me pyetjen 6, dëshirojmë t'Ju sqarojmë qe hartat e prodhuara nga kompania Datech, kane qene baza e regjistrimit te fondit pyjor dhe kullisor pranë zyrave dhe ne bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore te Kadastrës. Sigurisht qe këto harta mbajnë te dhëna vetëm për fondin pyjor dhe kullisor te ekonomisë pyjore e cila është filtruar, korrigjuar e me pas dakordësuar dhe propozuar nga Strukturat Përgjegjëse për Pyjet pranë NJ.Q.V, për t'u aprovuar nga Këshilli Bashkiak. Po ashtu, kjo harte dhe te dhënat qe kane buruar nga ajo, është përdorur gjate hartimit te planeve te mbarështimit, si e vetmi instrument legal dhe ne përputhje te plote me aktet ligjore (VKM) te cilat i kane kaluar ne pronësi NJ.Q.V fondin pyjor dhe atë kullisor.	Përfunduar	0
----	------------	--	------------	---	------------	---

		pika d, e keni transferuar kërkesën që ta trajtojnë koordinatorët për informim pranë bashkive Has, Malësi e Madhe, Korçë, Maliq, Berat dhe Gramsh. 1. A i keni miratuar ju këto plane për të cilat ju shpreheni se nuk zotëroni informacion? 2. Nëse po, cilat plane keni miratuar? 3. A keni miratuar ju në kundërshtim me ligjin 57/2020 “Për Pyjet” ndryshimin e kufijve të parcelave si dhe fshirjen e parcelave nga Regjistri Kadastral përsëri në kundërshtim me po të njëjtin ligj? 4. Referuar tabelës së mësipërme çfarë shërbimesh janë paguar për secilin zë? 5. A janë paguar me këto fonde hartimet e planeve të mbarështimit të				
--	--	--	--	--	--	--

		bashkive për të cilat ju shpreheni se nuk keni informacion? 6. Si ka mundësi që hartat e prodhuara nga kompania Datech janë të njëjta me ato të krijuara në këto plane mbarështimi?				
29	16.05.2024	Kërkese për informacion ne lidhje me: -Në çfarë faze është hartimi i projektligjit për ‘Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve?’ 2- Kur pritet të publikohet ky draft, dhe a mund të na vini në dispozicion një draft fillestar ose një përmbledhje të tij? 3- Ministria Mirela Kumbaro në takim me bashkimin e prodhuesve, tha se Lista e Gjellbër do përfshihet në ligjin e ri. Cilat mbetje do të lejohet të importohen që	30.05.2024	Projektligji “Për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” është në faze draftimi nga Grupi i Punës, ne përputhje me planifikimin dhe ne PKIE.Drafti do të publikohet në faqen e konsultimit publik, pasi të ketë përfunduar procesi i draftimit, por për momentin nuk japim dot një afat të caktuar. Sa lidhet me Listën e Gjellbër në ligjin e ri, kjo do të konsiderohet në kuadrin e transpozimit të EU ‘Acquis’ për fushën e mbetjeve.	Përfunduar	0

		do përdoren si lëndë djegëse nga industria e çimentos, prodhuese dhe ricikluese? 4- Për çfarë mbetjesh bëhet fjalë? 5- Cilat janë mbetjet e Listës së Gjelbër, që do lejohet të importohen? 6- Si do të bëhet prodhimi i energjisë përmes këtyre mbetjeve? 7- A mund të na vini në dispozicion ndonjë analizë të përfitimeve që do të kemi nga kjo masë për lejimin e importit? 8- Kur pritet të nisë importi i tyre? 9- Sa e garantuar është mbrojtja mjedisore nëse këto mbetje do importohen?				
--	--	---	--	--	--	--

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo muaj.

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës.
- (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

- (5) Ndhmon kërkesin për të njohur ecurinë e procesit.
- (6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.